



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 7340 Prot.

Fier më 18.06.2025

**Projekt - Vendim**

Nr. 58 Dt. 18.06.2025

**“Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për interes publik për pasuritë e paluajtshme pronë private , që preken nga realizimi i projektit “ Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” Segmenti Kryqezimi me Rrugen “Mujo Ulqinaku”-Kryqëzimi me Unazën “Skëndërbeu” zgjerimi i rrugës” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier , për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”**

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt..../...../2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga Komisioni i Shpronësimi dhe vlersimit paraprak ,ngritur me urdhër të Kryetarit me nr.149 datë 15.04.2025 “Për ngritjen e komisionit të shpronësimit dhe vlerësimit paraprak për pasuritë e paluajtshme,pronë private që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” Segmenti Kryqëzimi me Rr “Mujo Ulqinaku”- Kryqëzimi me unazën “Skëndërbeu”, zgjerimi i rrugës” , në lidhje me listën emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për pasuritë e paluajtshme, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” Segmenti Kryqëzimi me Rr “Mujo Ulqinaku”- Kryqëzimi me unazën “Skëndërbeu”, zgjerimi i rrugës” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier për përfundimin e miratimit të procesit të shpronësimit për interes publik.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “b”, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 54, gërma “k”, ekzekutivi :

**Propozon :**

1- Të miratojë tabelën me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve që do të shpronësohen për pasuritë e paluajtshme, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Kastriot Muço” Segmenti Kryqëzimi me Rr “Mujo Ulqinaku”- Kryqëzimi me unazën “Skëndërbeu”, zgjerimi i rrugës” ,vlerësim paraprak, më qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier sipas tabelës bashkëlidhur ;

2-Ngarkohet ekzekutivi I Bashkisë Fier për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit pranë Agjencisë Shtetërore Për Shpronësimin , MIE , Tiranë ;

**Komisioni I shpronësimit dhe vlerësimit paraprak për interes publik**

Esmeralda Kapllanaj

Pranvera Toska

Arbion Behari

Jetion Gjeka

Erald Tavanxhiu

Silvana Basha

Ilsidor Prifti

Dr. Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit

P.Çina

**KRYETARI**

**Armando SUBASHI**

**NË MUNGESË E ME AUTORIZIM**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Martin Dodi**

